

VENDIM
Nr. 1274, datë 25.2.2026

**PËR NJË NDRYSHIM NË RREGULLOREN “PËR PËRJASHTIMIN NË
BLLOK TË KATEGORIVE TË MARRËVESHJEVE VERTIKALE DHE
PRAKTIKAVE TË BASHKËRENDUARA”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z. Denar Biba	kryetar;
Znj. Leida Matja	zëvendëskryetar;
Znj. Rezana Konomi	anëtar;
Z. Durim Kraja	anëtar;
Znj. Fatjola Delija	anëtar,

në mbledhjen e tij të datës 25.2.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Mbi shfuqizimin e nenit 8 të Rregullores “Për përjashtimin në bllok të kategorive të marrëveshjeve vertikale dhe praktikave të bashkërenduara”, miratuar me vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 1249, datë 19.12.2025.

Baza ligjore: Neni 24, shkronja “d”, dhe neni 26 i ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të:

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës;
- VBER (EU) 2022/720;
- Vendimin e Komisioni i Konkurrencës nr. 1249, datë 19.12.2025, rregulloren “Për përjashtimin në bllok të kategorive të marrëveshjeve vertikale dhe praktikave të bashkërenduara”;
- Komentet e Komisionit Evropian;
- Projektvendimin e Komisionit të Konkurrencës “Për një ndryshim në rregulloren ‘Për përjashtimin në bllok të kategorive të marrëveshjeve vertikale dhe praktikave të bashkërenduara’”, miratuar me vendimin e Komisioni i Konkurrencës nr. 1249, datë 19.12.2025.

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për përjashtimin në bllok të kategorive të marrëveshjeve vertikale dhe praktikave të bashkërenduara”, miratuar me vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 1249, datë 19.12.2025, neni 8 shfuqizohet.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Kryetar: Denar Biba

Zëvendëskryetar: Leida Matja

Anëtarë: Rezana Konomi, Durim Kraja, Fatjola Delija